



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 26.12.2014, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Melihate Termkolli.

Munguan: Jakup Krasniqi dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi – DCAF, Petrit Hysaj – OSBE dhe Lekë Batalli – GLPS.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.12.2014;**
3. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
4. **Të ndryshme.**

***Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.12.2014

***Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23.12.2014, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetarja – Tha se thirrja e kësaj mbledhjeje kishte për qëllim që të diskutohet për raportin me amendamentet e Komisionit Funkcional në Projektligjin për buxhetin, por kjo nuk do të jetë e mundshme pasi që vendimi i Kryetarit të Kuvendit, pas shqyrtimit në parim, ka ngarkuar vetëm Komisionin për Buxhet dhe Financa. Gjithashtu, vlerësoi se ky vendim është në shpërpushje me Rregulloren e punës së Kuvendit, gjegjësisht me nenin 57. Pasi që Kryetari i Kuvendit ka vendosur që mos të përfshihen komisionet tjera, atëherë çka nëse raporti i Komisionit Funkcional ka ndonjë amendament që është në kundërshtim me Kushtetutën, pakëson të drejtat e njeriut, të komuniteteve apo nuk është në përputhje me *acquis communautaire*, pra nuk është e rastësishme kjo dispozitë ku parasheh që katër komisionet kryesore t'i shqyrtojnë amendamentet e Komisionit Funkcional. Ajo mori shembull edhe praktikën e mëhershme, p.sh. në vitin 2012 është bërë shmangie për shkurtim të afatit kohor, mirëpo prapë janë përfshirë edhe komisionet tjera, andaj kjo është tentim për të zbehur rolin e komisioneve parlamentare. Prandaj, pasi gjendemi para aktit të kryer, propozoj që t'ia dërgojmë një njoftim Kryesisë së Kuvendit, me shpresë që së paku në të ardhmen mos të ketë kësë veprimësh.

Armend Zemaj –Theksoi se ka qenë i pajtimt që të ketë mbledhje sot dhe të diskutohet pse Komisioni nuk është përfshirë fare në procesin e shqyrtimit të Projektligjit për buxhetin. Ai gjithashtu theksoi se po qe se në mbledhjen e Kryesisë vendoset që vetëm Komisioni për Buxhet të jetë i ngarkuar, propozoi që të dilet me një përfundim si Komision dhe t'i paraqesim vërejtjet tona për shmangien që i është bërë Komisionit për Legjislacion. Pra, duhet ta paraqesim një vendim të përbashkët, sepse në mënyrë individuale mund të kemi vërejtje, por atëherë nuk mund t'i paraqesim vërejtjet tona në emër të Komisionit. Ai gjithashtu tregoi se bashkë me katër kolegë të tij të LDK- së ka paraqitur një amendament që ka të bëjë me moszbatimin e Ligjit për kontributdhënësit prej vitit 1989 -1999, që është miratuar në mandatin e kaluar. Ai shtoi se nëse është anashkaluar Komisioni, kjo do të bëhet një praktikë e keqe.

Melihate Termkolli –Tha se ne po diskutojmë për diçka që nuk kemi as material, e as vendim të Kryetarit, lidhur me atë se nuk jemi përfshirë si Komision, pra ne vetëm po supozojmë. Ne po flasim për anashkalim të Komisionit, por këtu kemi shkelje të Rregullores së punës së Kuvendit dhe nuk dua të supozoj se a është bërë me qëllim apo pa qëllim, por ne këtë shkelje nuk mund ta pranojmë. Komisioni për Legjislacion, detyrimisht duhet t'i trajtojë amendamentet e Projektligjit për buxhetin. Është fjala për ligjin më të rëndësishëm. Ne sot nuk mund të shqyrtojmë asgjë pa e pasur raportin me amendamente. Propozoj që t'i drejtohem Kryesisë dhe të kërkojmë që të ngarkohet Komisioni për trajtimin e këtyre amendamenteve, para seancës. Po qe se nuk ndodh kjo, atëherë vihet në pikëpyetje edhe ekzistenca e këtij Komisioni. Pra, atëherë pse të ekzistojë ky Komision, nëse nuk shqyrton raportin me amendamente të projektligjit më kryesor.

Selvije Halimi – Në bazë të atij vendimi që u është shpërndarë deputetëve, tregon për shkurtim të afateve kohore, por jo edhe të procesit, sepse edhe Komisioni për Integritet e ka po të njëjtin problem. Pra, ne duhet të kërkojmë që Komisioni duhet të jetë i ngarkuar me shqyrtim të raportit, edhe pse ndoshta seanca do fillojë pak më vonë. Ajo gjithashtu theksoi se mund të ndodh që është bërë një lëshim, shmangie nga afati kohor, por jo edhe i procedurave dhe propozoi që të hënën, para seancës, të mblidhet serish Komisioni dhe të shqyrtojë raportin me amendamente.

Armend Zemaj –Theksoi se Kryesia nuk merr vendim, po vendimet merren në seancë. Sekretaria është në shërbim të deputetëve dhe Sekretaria duhet ta njoftojë Kryesinë për procedura. Kryesia nuk mund të bëjë propozime jashtë Rregullores së Kuvendit. Ai kërkoi nga kryetarja që të mblidhet Komisioni të hënën dhe të kërkojmë që të ngarkohemi si Komision, para shqyrtimit të dytë.

Melihate Termkolli –Theksoi se po qe se ne nuk do të kemi raportin për shqyrtimin e amendamenteve, atëherë të autorizohet kryetarja e Komisionit që të paraqesë një kërkesë, që ta kemi raportin për shqyrtimin e amendamenteve dhe të ceket që është bërë shkelje ndaj këtij Komisioni.

Kryetarja – Qëllimi kryesor i kësaj mbledhjeje ka qenë që të konstatohet shkelja e Rregullores dhe të kërkojmë që Komisioni për Legjislacion ta ketë raportin me amendamente nga Komisioni për Buxhet.

Doruntinë Maloku –Theksoi se në kërkesë mos të cekët vetëm si formal, sepse mund të ndodhë që edhe herëve të tjera të sillen vetëm formalisht, pra të mos jemi vetëm formalisht.

Armend Zemaj – Ne duhet të jemi më praktikë, mendoj se nuk duhet të themi që kemi shkelje të Rregullores, vetëm po e kërkojmë shqyrtimin e raportit me amendamente. Atëherë, nëse vendoset që ne mos ta kemi atë raport, kur të mbledhemi të hënën, të diskutojmë për hapa të mëtutjeshëm.

Danush Ademi –Theksoi se pika e tretë e rendit të ditës është dashur të hiqet, për arsye se nuk e kemi raportin, pra po diskutojmë për këtë pikë, e që asgjë nuk kemi në tavolinë.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me parafolësin, sqaroi arsyen pse nuk është hequr kjo pikë e rendit të ditës, pra arsyeja është që të diskutojmë për hapat që do t'i ndërmarrim.

Selvie Halimi – Në fjalën e saj të serishme, ajo tha se nuk është i paligjshëm vendimi i Kryetarit, sepse Kryetari me atë vendim e obligon Komisionin për Buxhet dhe Financa, por neve nuk na e ndalon ta shqyrtojmë raportin me amendamente. Andaj, ne do t'i drejtohem me një kërkesë Kryesisë së Kuvendit, ku do të kërkojmë që të na sillen raporti me amendamente për shqyrtim.

Nezir Çoçaj –Theksoi se po qe se ka qenë fjala vetëm për një kërkesë, atëherë ka mundur të përpilohet nga kryetarja dhe dy nënkryetarët, pasi që ne shumica udhëtojmë dhe gjithashtu kishte një vërejtje teknike, për arsye të udhëtimit kërkoj që gjithë dokumentacionin ta ketë edhe në adresë elektronike.

Kryetarja – Sqaroi se disa dokumente apo raporte nuk vinë në mënyrë elektronike dhe është problem t'i kemi të gjitha në adresat elektronike. Sot ndoshta ka qenë shumë shpejt kjo mbledhje, por ka qenë si mbledhje e jashtëzakonshme, prandaj në të ardhmen të gjitha dokumentet do t'i keni me kohë.

Në fund, Komisioni ngarkoi Albulena Haxhiun, Selvie Halimin dhe Danush Ademin, që ta përgatisin kërkesën për Kryesinë e Kuvendit, ku do të kërkohet që të ngarkojë Komisionin për Legjislacion, që ta shqyrtojë raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, para shqyrtimit të dytë në mbledhjen plenare, sipas nenit 57 të Rregullores së Kuvendit.

Me këtë pikë të rendit të ditës, kryetarja konstatoi se mbledhja përfundoi dhe se takimi i radhës do të jetë të hënën, më 29.12.2014, në orën 9:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu